



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
ZYRA JURIDIKE

Nr 552/3 Prot.

Gjirokastër më, 02.04.2025

UDHËZIM

PËR

**RESPEKTIMIN E PARIMEVE TË PAANËSISË DHE MOSPËRDORIMIT TË
BURIMEVE PUBLIKE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE NË UNIVERSITETIN
"EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Neneve 77, 78, pika 6 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "Për rregullat për mënyrën e përgatitjes dhe publikimit të informacionit zyrtar nga institucionet publike, ndalimin e përdorimit të burimeve publike dhe pjesëmarrjen e personave që ushtrojnë funksione publike në veprimtari zgjedhore", i ndryshuar, si dhe në përputhje me normat e etikës dhe integritetit institucional në arsimin e lartë publik, Rektori i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, nxjerr këtë udhëzim për rregullat e sjelljes institucionale dhe administrative gjatë periudhës zgjedhore.

NENI 1
QËLLIMI

Ky udhëzim synon të garantojë respektimin e parimeve të neutralitetit, paanësisë politike dhe mospërdorimit të burimeve publike të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër për qëllime të fushatës zgjedhore, duke mbrojtur integritetin e institucionit dhe besimin e publikut në misionin e tij arsimor dhe shkencor.

NENI 2
FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzim është i detyrueshëm për të gjitha njësitë akademike dhe administrative të Universitetit, përfshirë:

- Rektoratin
- Fakultetet dhe Departamentet
- Qendrat Kërkimore dhe Projekteve

- Stafin administrativ dhe teknik
- Personelin akademik me detyra drejtuese

NENI 3

MBËSHTETJA LIGJORE

Ky udhëzim mbështetet në dispozitat ligjore që ndalojnë përdorimin e funksioneve publike dhe burimeve publike për qëllime zgjedhore, përfshirë:

Neni 78 i Kodit Zgjedhor, që ndalon institucionet publike të përdorin burimet institucionale për të ndikuar në fushatë.

Neni 79, që ndalon publikimin e arritjeve apo aktiviteteve promovuese që mund të shihen si propagandë politike.

Vendimi nr. 9/2020, i cili detajon ndalimet për përdorimin e burimeve njerëzore, logjistike dhe informacionit institucional në favor të subjekteve zgjedhore.

NENI 4

NDALIMI I PËRDORIMIT TË BURIMEVE PUBLIKE

Është rreptësisht e ndaluar përdorimi i:

- Ambjenteve të universitetit për aktivitete zgjedhore;
- Automjeteve, pajisjeve kompjuterike apo mjeteve të tjera institucionale për qëllime politike;
- Shërbimeve të stafit akademik ose administrativ për të mbështetur ndonjë subjekt zgjedhor.
- Çdo shkelje do të konsiderohet si shkelje administrative dhe do të referohet për ndjekje disiplinore dhe, në rastet e përcaktuara, edhe penale.

NENI 5

SJELLJA E PUNONJËSVE GJATË FUSHATËS

Punonjësit e universitetit kanë të drejtën e tyre për përkatësi politike, por jashtë ambienteve dhe orarit të punës. Angazhimi personal në fushatë nuk duhet të ndikojë në neutralitetin institucional apo të shoqërohet me referenca ndaj funksionit publik të mbajtur.

NENI 6

KOMUNIKIMI DHE PUBLIKIMET ZYRTARE

Gjatë fushatës zgjedhore, ndalohet:

- Publikimi në faqen zyrtare të universitetit apo rrjete sociale i çdo materiali që mund të konsiderohet propagandë;

- Organizimi apo promovimi i arritjeve të universitetit që mund të interpretohen si pjesë e një strategjie elektorale.
- Të gjitha publikimet duhet të miratohen nga Rektorati për të siguruar përputhshmëri me udhëzimin dhe ligjin zgjedhor.

NENI 7 DETYRIMI PËR RAPORTIM

Drejtuesit e njësive përbërëse kanë detyrimin të:
Informojnë stafin për përmbajtjen e këtij udhëzimi;
Raportojnë çdo rast të dyshuar të shkeljes pranë Rektoratit dhe/ose autoriteteve përgjegjëse.

NENI 8 MASA PËR SHKELJET

Të meren masa për zëvendësimin e personelit akademik që do të pezullohet për shkak të kandidimit.

Kushdo tjetër që do të marrë pjesë apo do të angazhohet në struktura të tjera si komisioner pranë KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, të njoftojë Rektorin e Universitetit dhe drejtuesin e njësisë kryesore, dhe Drejtorinë Juridike të Burimeve Njerëzore.

Çdo shkelje e këtij udhëzimi përbën shkelje të etikës dhe detyrimeve ligjore dhe do të procedohet sipas:

- Ligjit për statusin e punonjësve të administratës publike;
- Ligjit për arsimin e lartë publik;
- Kodit Zgjedhor dhe vendimeve përkatëse të KQZ-së.

NENI 9 HYRJA NË FUQI

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe ka efekt deri në përfundimin zyrtar të procesit zgjedhor.

REKTOR

PROF. DR JAHO ÇANA

